



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE


PRIMARY
EDUCATION PROJECT

Kodeksi
etik

PËR TESTIMIN
E DITURIVE TË
NXËNËSVE



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
ГРАЃАНСКО
ОБРАЗОВАНИЕ



Përgaditja e këtij kodeksi është finansuar nga populli amerikan përmes Agjensisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar (USAID) në kuadër të **Projektit për arsimin fillor**, komponenta *Përparim i notimit të nxënësve*.

Qëndrimet e autorëve të shprehur në këtë kodeks janë në përgjegjësi të Projektit për arsimin fillor dhe nuk i përfaqësojnë qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kodeksin e përgaditi:

Gorica Mickovska në bashkpunim me Grupën punues të komponentës Përparim i notimit të nxënësve.

Përkthim në gjuhën shqipe:

Zekirija Ibraimi

Përgaditja grafike:

Koma lab.



HYRJJE

Hyrje

Kontrollimi dhe notimi i diturive të nxënësve me ndihmën e testeve të diturive shpeshherë vetvetiu merret si i besueshëm dhe objektiv. Testet e diturive, veçmas testet objektive, kanë potencial të madh që ta matin mirë diturinë e nxënësve dhe pastaj të dhënat e fituara të përdoren për qëllime përmbledhëse ose formative. Megjithatë, gjatë procesit, që nga marrja e vendimit për zbatimin e testimit, e deri te interpretimi dhe përdorimi i rezultateve të testit, ekzistojnë shumë pika kritike që mund t'i rrezikojnë përparësitë që rëndom u përshkruhen testeve. Një pjesë e tyre shkaktohen nga profesionalizmi i pamjaftueshëm i personave që janë të përfshirë në testim, por edhe nga mosrespektimi i principeve etike në këtë proces.

Ky kodeks merret me etiken gjatë testimit të diturive të nxënësve dhe ka të bëjë me të gjitha llojet e testimit: si me testet e përgatitura dhe të zbatuara nga arsimtarët, ashtu edhe me testet e përgatitura dhe të zbatuara në mënyrë eskterne¹.

1 Për testimet eksterne pritet që, përveç rregullave themelore në këtë kodeks, të përgatiten edhe udhëzime të veçanta dhe akte të tjera normative.

Qëllimi i kodeksit është që ta ngrejë vetëdijen e të gjithëve që janë të inkuadruar në teste për rëndësinë e sigurimit të sjelljes profesionale dhe etike në lidhje me testimin e diturive të nxënësve dhe që sjellja joprofesionale dhe joetike të bie në minimum. Prandaj është me rëndësi që rregullat e testimit të diturisë të jenë të qarta dhe të njohura për të gjithë që janë të inkuadruar në këtë proces dhe për të gjitha palët e tjera të interesuara.

Kodeksi është një praktikë e mirë e testimit të diturive, drejt të cilave synohet dhe në të cilat veçmas theksohen sjelljet joetike që i rrënojnë rregullat themelore për testim korrekt dhe objektiv.

Gjatë hartimit të këtij kodeksi janë përdorë kodekse të ngjashme për testim². Kodeksi është në pajtim me Udhëzimet për notim në shkollat fillore,³ me standardet dhe procedurat e notimeve nacionale⁴ dhe me Kodeksin etik për notimin e të arriturave të nxënësve⁵.

2 - Code of Fair Testing Practices in Education(2004), Washington D.C.:Joint Commity on Testing Practices
- Standard Test Administration and Testing Ethics Policy for Utah Educators, Patty Harrington, Ed.D., Utah State Office of Education, <http://www.schools.utah.gov/arc/AAEthicsPolicy.pdf>, 15.05.2011

3 - Udhëzimi për notim në shkollat fillore, i miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendimin nr. 07158/1 të datës 21.02.2008

4 - Mickovska G. (2005), Notimi nacional në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë, Standarde dhe procedura, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Njësia për notim (dokument interno).

5 - Kodeksi etik për notimin e të arriturave të nxënësve, (2009), Grupi punues për komponentin "Përparimi i notimit", Projekti i USAID-it për arsimin fillor.

PRINCIPET

Principet

Për testimin e diturive vlejnë principet e ngjashme si për çdo notim tjetër kualitativ të diturive.

- **Testimi i diturive duhet të jetë korrekt.** Testimi duhet të jetë i menduar dhe i realizuar ashtu që rezultatet e testit të varen vetëm nga të arriturat që maten, e jo edhe nga veçori të tjera të nxënësit (p.sh.: prejardhja sociale, gjinia, nacionaliteti...)
- **Testimi i diturive duhet të jetë i besueshëm dhe i sigurt.** Testet duhet t'i matin ato dituri që synohet të maten. Notimi i testeve është konsistent nga njëri te notuesi tjetër.
- **Testimi i diturive duhet të jetë transparent.** Duhet të dihet qartë se çfarë diturish mat testi dhe për çfarë qëllimesh përdoren rezultatet e fituara. Testimet duhet të jenë të paralajmëruara që më parë.

QËLLIMI I TESTIT

Qëllimi i testimit të diturive

✓ Testimi duhet t'u mundësojë nxënësve që t'i dëshmojnë dituritë dhe kompetencat e tyre në fushën/lëndën në të cilën bëhet testimi.

Rezultatet e testimit u shërbejnë:

Nxënësve – të shohin se në çfarë mase i kanë arritur qëllimet dhe rezultatet e pritura, të parashikuara me programet mësimore.

Prindërve – të shohin se a i ka përvetësuar fëmija i tyre dituritë e parashikuara dhe sa ka qenë i suksesshëm në atë, si dhe ku gjendet ai në krahasim me nxënësit e tjerë.

Arsimtarëve – të shohin se çka kanë arritur nxënësit e tyre dhe ku janë dobësitë e të arriturave, me qëllim që ta përmirësojnë mësimin dhe t'u ndihmojnë nxënësve t'i tejkalojnë lëshimet.




MITTËDITURIVE

Shkollave – që të shohin se sa kanë qenë të suksesshme në realizimin e programeve dhe që t'i përmirësojnë ende ato, si dhe t'i shfrytëzojnë njohuritë e fituara për të formuar grupe për mësim plotësues dhe shtues, për përparimin e nxënësit në vitet e ardhshme dhe gjatë përzgjedhjes për shkallët vijuese në arsim.

Autoriteteve qendrore dhe lokale – që të shohin se sa kanë qenë të suksesshme në arritjen e qëllimeve në arsim, që t'i identifikojnë fushat e dobëta dhe ta vlerësojnë punën e shkollave, gjithë kjo me qëllim që të përmirësohen të arriturat e nxënësve.

Një test mund t'u shërbejë më shumë përdoruesve, por një test mund të përdoret me sukses për të gjitha qëllimet. Prandaj për qëllime të ndryshme përgatiten teste të ndryshme.



Testimi nuk guxon të shërbejë për frikësimin dhe ndëshkimin e nxënësve dhe të arsimtarëve, si dhe për përfitimin e privilegjeve të paarsyeshme. Rezultatet e testimit nuk guxojnë të përdoren për qëllime të tjera, pos atyre për të cilat janë të dedikuara: matja e të arriturave të nxënësve me qëllim që të vlerësohen të arriturat dhe të përmirësohet mësimdhënia dhe mësimi.

Përgatitja për testim gjatë mësimdhënies

Kontrollimi i diturive me ndihmën e testeve është pjesë përbërëse e mësimdhënies dhe mësimimit. Etika në testim është pjesë e etikës në mësim dhe në notim.

Arsimtarët duhet:

- Të sigurojnë të mësuar dhe mësim për të gjitha përmbajtjet dhe kompetencat që janë pjesë e programeve mësimore dhe që duhet të kontrollohen me teste.
- Ta dinë se cilat dituri dhe shkathtësi mund të kontrollohen me teste të ndryshme (edhe objektive, edhe eseistike) dhe të insistojnë që ato t'i zhvillojnë gjatë mësimdhënies.
- T'u mundësojnë nxënësve që gjatë gjithë vitit shkollor në mënyra të ndryshme t'i demonstrojnë të arriturat e tyre, duke përfshirë edhe zgjidhjen e atyre testeve që do të përdoren.
- T'i aftësojnë nxënësit për lexim dhe kuptim të kujdesshëm të instruksioneve dhe detyrave në teste dhe për përdorim racional të kohës gjatë zgjidhjes së testeve.
- Gjatë mësimimit bashkë me nxënësit t'i analizojnë gabimet që bëhen gjatë zgjidhjes së testeve, që kështu t'i tejkalojnë gabimet që bëhen nga pakujdesia, nga moskuptimi i udhëzimeve dhe nga qasja joadekuate në përgjigjet e py-

NGJATË MËSIMDHËNIES

etjeve të testit, si dhe me qëllim që t'i zbulojnë shkaqet e të kuptuarit të gabuar dhe kështu t'u ndihmojnë për t'i tejkaluar ato.

- Me inkuadrimin e nxënësve në përgatitjen dhe shqyrtimin e pyetjeve të testit që përdoren në qëllimet formative ta zvogëlojnë stresin nga kontrollimi i diturive përmes testeve.
- Të mos i përgatisin nxënësit për t'u përgjigjur në teste përmes memorimit të pyetjeve që janë përfshirë në teste të mëparshme.
- Të mos i përgatisin nxënësit për t'u përgjigjur në pyetje konkrete për të cilat që më parë e dinë se do të jenë pjesë e testit.
- T'i informojnë nxënësit dhe prindërit për llojet dhe kohën e testimit gjatë vitit shkollor dhe për mënyrën e përdorimit të rezultateve nga testimi.



Testet dhe mënyra e matjes së diturive dhe kompetencave nuk guxojnë të jenë befasi për nxënësit.

PERGATITJA DHE ZG

Përgatitja dhe zgjedhja e testeve

✓ Testet e diturisë i hartojnë institucione të specializuara, por edhe arsimtarët. Testet e diturisë i shfrytëzojnë institucionet shtetërore, por edhe arsimtarët e nxënësve. Prandaj ndonjëherë ata që i hartojnë dhe që i shfrytëzojnë testet janë faktikisht personat/institucionet e njëjtë/njëjta, por ndonjëherë edhe dallohen.

Gjatë hartimit dhe/ose zgjedhjes së testeve pritet:



GJEDHJA E TESTEVE

Hartuesit e testeve

1. Të sigurojnë që testi të jetë adekuat me qëllimin e testimit dhe të japë informacione dhe dëshmi për atë se çka matet në test dhe për cilën popullatë është i dedikuar ai, si dhe të japë informacion për përparësitë dhe kufizimet e testit.
2. Të japin informacione për atë se si janë zgjedhë përmbajtjet dhe qëllimet mësimore që testohen (skema specifike e testit) dhe si është përgatitur testi.
3. Të sigurojnë informacione për karakteristikat e testit (besueshmëria, siguria, pesha) dhe ato t'i ofrojnë në mënyrë të kuptueshme për përdoruesit⁶.
4. Të japin orientime përkatëse profesionale për përdorimin e testit (dhënia, interpretimi).
5. Të përgatisin modifikime për fëmijët me nevoja të ndryshme të veçanta.
6. Bashkë me testin të sigurojnë edhe udhëzim përkatës për dhënien dhe notimin e testit.


Shfrytëzuesit e testeve

1. Të zgjedhin test që është në harmoni me qëllimin e testimit, me përmbajtjet dhe qëllimet mësimore që do të testohen dhe me nxënësit që do të testohen.
2. Të zgjedhin test që i kontrollon përmbajtjet dhe qëllimet mësimore që do të testohen.
3. Të zgjedhin test në bazë të karakteristikave të tij matëse, nëse ato janë të njohura.
4. Të sigurojnë që personi që e përdor testin të ketë dituri përkatëse profesionale.
5. Për fëmijët me nevoja të veçanta të përdorin versione të përshtatura të testit.
6. Ta studiojnë udhëzimin për dhënien dhe notimin e testit dhe atë ta respektojnë.

6 Kjo para së gjithash pritet nga testet që janë të dedikuara për testimet eskterne

DHËNIA E

Dhënia e testit



Sa është e rëndësishme të sigurohet test cilësor, po aq është e rëndësishme që ai të jepet ashtu që të sigurojë testim korrekt. Sjellja joetike bie në sy në procesin e dhënies së testit.

Me qëllim që testimit të jetë korrekt, përdoruesit e testit duhet të sigurojnë:


- që testet të ruhen në vend të sigurt deri në kohën e testimit.
- prani të të gjithë nxënësve që duhet të përgjigjen në test (me përjashtim të atyre që mungojnë me arsye)
- udhëzime të shkruara dhe trajnim të veçantë për krahasimin e testimeve eksterne dhe të testimeve shkollore, nga rezultatet e të cilave në masë të madhe varet përparimi i nxënësit.
- respektimi i udhëzimeve të dhëna për krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë nxënësit dhe mbikëqyrje e vazhdueshme e rregullsisë së testimit nga personat që e japin testin.

TESTIT

- kushte përkatëse për realizim të papenguar të testit (kushte për punë të pavarur dhe të përqendruar të nxënësve).
- të gjithë nxënësit t'i kenë kuptuar mirë udhëzimet për t'u përgjigjur në pyetje dhe mënyrën e dhënies së përgjigjeve.


Në këtë rast nuk lejohet që:

- para testimit nxënësve, prindërve ose të tjerëve që janë të interesuar t'u jepen informacione në lidhje me detyrat konkrete të testit ose t'u jepen kopje të testeve që t'i shikojnë;
- t'i ndihmohet nxënësit gjatë dhënies së përgjigjeve (t'i tregohet përgjigjja ose të udhëzohet në përgjigje përmes shpjegimeve plotësuese ose përmes orientimeve në të menduar);
- nxënësit të përdorin pajisje joadekuate që do t'u ndihmojnë të përgjigjen në pyetjet e testit (p.sh.: konsultim mes vete, përskrim, materiale plotësuese, telefona celularë, të dalin gjatë kohës së testimit etj.);
- të vazhdohet koha e testimit të nxënësve të caktuar (përveç nëse nuk bëhet fjalë për teste të përshtatura për nxënës me nevoja të veçanta arsimore).



KONTROLLIMI

Kontrollimi dhe notimi i testeve



Kontrollimi dhe notimi i nxënësve është fazë e procesit të testimit në të cilën lehtë mund të paraqitet sjellje joprofesionale dhe joetike.

Pas përfundimit të testimit:

- të gjitha testet duhet të mblidhen dhe të ruhen në vend të sigurt deri në fillimin e kontrollimit dhe notimit.
- gjatë notimit të testeve me besnikëri duhet të respektohet udhëzimi për notim dhe dhënie të pikëve. Nëse bëhet fjalë për pyetje të hapura, që kanë ndikim të madh në përparimin e nxënësve, duhet të sigurohet edhe kontrollim plotësues i përshtatshmërisë së notimit me udhëzimin për notim.
- të shpjegohet dhe të arsyetohet mënyra e shndërrimit të rezultateve/pikëve të testit në nota gjithnjë kur bëhet kjo.
- testet e notuara të ruhen një kohë që të shërbejnë si dëshmi në rast të ankesave ose kur ka nevojë për shpjegime plotësuese.

Në këtë rast nuk lejohet që:

- në asnjë mënyrë të intervenohet në testet e zgjidhura të nxënësve.

SHPALLJA

Shpallja dhe përdorimi i rezultateve

Që testimi t'i shërbejë qëllimit për të cilin është i dedikuar, me rëndësi është që rezultatet e testimit t'u kumtohen në mënyrë përkatëse përdoruesve.

Në lidhje me rezultatet duhet të mbahet llogari për këtë:

- Rezultatet e nxënësve mund të shpallen në mënyrë që më parë të përcaktuar, me ç'rast duhet të ruhet privatësia e nxënësve.
- Rezultatet e testimit duhet që në periudhë të arsyeshme kohore dhe në mënyrë përkatëse t'u kumtohen dhe t'u shpjegohen nxënësve dhe prindërve.
- Rezultate e testimit duhet të përdoren për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimin.
- Gjatë përpunimit të rezultateve shkolla duhet të bëjë analizë të të arriturave për lëndë/fusha të caktuara.
- Parapëlqehet që arsimtari të bëjë analizë të gabimeve tipike që i bëjnë nxënësit në test për gjithë paralelen ose për secilin nxënës veçmas. Në këtë proces është mirë të përfshihen edhe vetë nxënësit. Njohuritë e këtyre analizave mund të këmbehen me prindërit.
- Rezultatet e testeve mund të përdoren për notimin e nxënësve ashtu siç është parashikuar me kriteret për

shndërrimin e pikëve në nota, të cilat janë vendosur qysh më parë.


- Nëse bëhet fjalë për teste të standardizuara, atëherë bashkë me rezultatet duhet të jepen edhe informacione që do ta lehtësojnë interpretimin e rezultateve (norma ose krahasime ndërmjet nëngrupeve), si dhe mundësi për përdorimin dhe kufizimet, duke përfshirë edhe tërheqjen e vërejtjes se testi nuk guxon të përdoret për qëllime për çka nuk është i dedikuar dhe nuk guxon t'i jepet më shumë precizitet se ç'është përcaktuar.

Në këtë rast nuk lejohet që:

- Rezultatet e testeve të përdoren për qëllime të tjera, përveç për qëllimin për të cilin janë të dedikuara.
- Gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme për nxënësin (p.sh.: dhënia e notës vjetore, regjistrimi në shkollën e ardhshme të arsimit) rezultatet e testit duhet të jenë baza e vetme për marrjen e vendimeve.
- Rezultatet e testeve të diturive të nxënësve nuk guxojnë të përdoren për vlerësimin e arsimtarëve dhe të shkollave, nëse në mënyrë statistikore nuk janë të mbuluara me tregues validë për ndikimet e faktorëve të tjerë ndaj rezultateve të testit (p.sh.: niveli i arsimit të prindërve, prejardhja sociale e nxënësve, dituritë paraprake, përvojat paraprake me testimin, kushtet në shkollë etj.).

INFORMIMI

Informimi i prindërve dhe nxënësve



Nxënësit duhet të kenë informacione përkatëse për qëllimet e testimit, për përmbajtjen e testit, për detyrimet e dhënies së përgjigjeve në test dhe për të drejtat që i gëzojnë, si dhe për mënyrat e përdorimit të rezultateve dhe të drejtën e ankesave.

Në lidhje me këtë:

- Nxënësit qysh më parë duhet të informohen se kur do të kenë test, cili është qëllimi i testit dhe cilat përmbajtje do të përfshihen me test. Po ashtu ata duhet të informohen për tipat e pyetjeve në test, si dhe të udhëzohen për dhënien e përgjigjeve.
- Nëse dhënia e përgjigjeve në test nuk është e detyrueshme, prindërit dhe nxënësit duhet të informohen për anët e mira dhe të dobëta të vendimit që testi të zgjidhet ose jo, si dhe për atë se a ekziston alternativë nëse testi nuk zgjidhet.
- Nxënësit dhe prindërit qysh më parë duhet të informohen për të drejtat eventuale për të pasur qasje në testin e notuar.
- Nxënësit duhet të jenë të informuar për rregullat e dhënies së përgjigjeve në test, për pasojat e mosrespektimit të rregullave dhe për marrjen eventuale të pikëve për dhënie të përgjigjeve të gabuara.

- Prindërit dhe nxënësit duhet të jenë të informuar për rregullat në lidhje me ruajtjen dhe shpalljen e rezultateve të testimit.
- Nxënësit dhe prindërit duhet të jenë të informuar për të drejtën e ankesës në rast të mospërputhjes së rezultateve të testit ose të paraqitjes së rastit të mosrespektimit të procedurave për realizimin e testimit.
- Gjatë informimit të nxënësve dhe prindërve për rezultatet e testit, arsimtari duhet t'u përmbahet fakteve dhe mos të japë mendime të tij personale që kanë të bëjnë me sjelljen dhe personalitetin e nxënësit. Ai mund të japë këshilla në lidhje me të mësuarit e mëtejme.

Në këtë rast nuk lejohet:

- Krahasimi i nxënësve me njëri-tjetrin dhe rangimi i nxënësve sipas rezultateve të arritura në test, nëse testi nuk është i dedikuar për përzgjedhje.



KONTROLLIMI

Kontrollimi i shpejtë i etikes gjate testimit

✓ Është në interes të të gjithëve që secili nxënës në test ta arrijë atë rezultat që është i besueshëm dhe objektiv dhe që i shpreh dituritë që maten me atë test.

Mënyra më e mirë që të vlerësohet se ndonjë veprim i cilitdo që është i inkuadruar në procesin e testimit është etike është që të jepet përgjigje (me mohim) në këto pyetje:

- A do t'i shtrembërojë ai veprim rezultatet e testimit dhe ashtu të fitohen të dhëna që nuk do të jenë të besueshme?
- A u jep ai veprim disa nxënësve përparësi në raport me disa nxënës të tjerë, ndërsa kjo nuk është për arsye të dallimeve të tyre në dituri?
- A do t'i mundësojë ai veprim nxënësit që të përgjigjet në pyetjet e testit, në të cilat ai rëndom nuk do të përgjigjej?
- Nëse nuk do të bëhej ai veprim, a do të ishte ndryshe përgjigjja e nxënësit?
- A do të rezultojë ai veprim me pasqyrë të gabuar për diturinë e përmbajtjeve që testohen?
- A do të ndërmerrej veprimi i njëjtë edhe atëherë kur ekzistojnë njohuri se dikush e mbikëqyrë atë që bëhet?



